

Fazli Syla

KARAKTERI NJOHËS DHE EDUKUES I LETËRSISË POPULLORE

Krijimtaria letrare popullore, sikurse edhe krijimtaritë e tjera shpirtërore, pos të tjerash, cilësohet me dimensionin njohës dhe edukues. Nëpërmjet trajtimit të fenomeneve e dukurive të ndryshme që lidhen me botën dhe me njeriun — të shprehura me gjuhën poetike e të materializuara në tekstin artistik — veprat letrare, e në kuadrin e tyre edhe ato të letërsisë popullore, krahas zhvillimit të ndjenjës artistike, si detyrë parësore e veprës letrare, ofron edhe informacion të caktuar. Pra, duke shprehur probleme e dilema të botës e të njeriut vepra letrare, në të vërtetë, ofron qëndrimin e krijuesit për to, që asnjëherë nuk është thjesht individual, por si shprehje e një përvoje të fituar jetësore të tij, të rrethit ku jeton dhe të njeriut në përgjithësi. Nëpërmjet veprës letrare krijuesi na thëllon në problemet shoqërore e sociale të meseve të ndryshme, por edhe në botën e brendshme të njeriut si individ. Vetë fakti se vepra letrare shtron probleme të rëndësishme dhe ofron mundësi që secili të nxjerrë përfundimin e vet për to, duke i pranuar ose mohuar, dëshmon edhe për karakterin njohës të saj, e natyrisht edhe për dimensionin edukues. Natyrisht këto dy komponente në një veprë janë të theksuara, në një tjetër më pak, varësisht nga problemi i trajtuar dhe nga qëllimi i autorit të veprës së hartuar letrare.

Në kuadrin e artit letrar, edhe letërsia popullore gjithnjë ka qenë formë e shprehjes së drejtpërdrejtë e përpjekjeve, normave, synimeve dhe idealeve të masës si dhe shprehja më e mirë e të çmuarit të së bukurës, të drejtës e humanes. Kështu arti popullor, si edhe ai gojor, duke krijuar figura të bukura e ideale, të bazuara në jetë e realitet, i nxjerr ato si përfaqësuese të grupeve, dukurive e fenomeneve që përfshihen në tërësinë e shoqërisë me të gjitha karakteristikat e veçanta të saj, me një skicim të posaçëm të asaj çka është ideale, e madhërishme e pozitive dhe çka është e pranueshme për normat, mentalitetin e botëkuptimet e shoqërsisë.¹

Letërsia popullore, posaçërisht kënga popullore e ka ndjekur popullin në luftëra e fitore, ka shprehur përjetimet e botëkupti-

¹ A. Uçi, *Probleme të estetikës*, „Rilindja” Prishtinë, 1980 f. 47.

met individuale e kolektive të tij, pra, ajo, si e tillë, nxjerr në pah më të qenësishmen nga jeta e popullit. Krijuesit popullorë krijojnë shumë, por mbetet për një kohë më të gjatë vetëm ajo pjesë që shpreh botën shpirtërore të popullit, që shpreh një pjesë të jetës së tij. Gjithë kjo krijimtari është thesar i popullit të caktuar, që e krijon, por si e tillë ajo është edhe kontribut në fondin e kulturës së përgjithshme. Kështu, pra, kemi komponentën individuale të çdo populli, por edhe atë të përgjithshmen, njerëzoren. Njeriu duke shprehur mendimet e veta për botën, për vete, për njeriun dhe ngjarjet që lidhen me të, shpreh edhe mendimet e ambientit, pjesë integrale e të cilit është ai vetë.

Letërsia popullore ka shërbye si bazë ose mbështetje e letërsisë së shkruar, ajo ka qenë shkollë e parë e shumë krijuesve të veprave të mëdha letrare. Pothuajse në çdo kohë ajo është vënë në shërbim të artit në përgjithësi dhe të letërsisë së shkruar posaçërisht, duke e shfrytëzuar thesarin e saj të pasur estetik dhe duke i dhënë atij formë të re. Pra, në gurrën popullore janë mbështetur shkrimtarët më të shquar të letërsisë botërore si dhe figurat më të dalluara të letërsisë shqipe, si De Rada, Dara, Naimi, Fan Noli, Poradeci, Spasse e të tjerë.

Për arsye të mënyrës së trajtimit të kontradiktave klasore, animit kah masat e gjera, të shtypura e të pambrojtura dhe për arsye të rezistencës që i bëhet shtypjes e keqtrajtimit të njerëzve si dhe revoltës që shprehet ndaj tyre, folklorin gojor e kanë studiuar me andje edhe klasikët e marksizëm-leninizmit, si një forcë nxitëse që u kontribuon përpjekjeve të gjithmbarshme të popujve të ndryshëm për progres.

Folklori ynë gojor lidhet me tema e motive të afërta për të gjithë, duke i përjetësuar ato në vargje ose në prozë. Kështu e gjithë letërsia popullore, veçanërisht poezia, përshkohet nga luftërat e synimet e përhershme sociale, historike, politike, kombëtare e njerëzore. Ky thesar i begatshëm nuk është i kthyer vetëm kah e kaluara, por ndikon shumë pozitivisht në jetën e përditshme në përgjithësi dhe në atë artistike në veçanti. Ai edhe në të kaluarën ka ruajtur rrugën e pavarur të zhvillimit të vet, pa ndikime të shtresave të larta për ta vënë në shërbim të vet dhe për ta degjeneruar. Kështu të gjitha shartimet e krijimet artificiale kanë qenë jetëshkurtra, sepse ato bëjnë rrugën e vet të natyrshme, pa diktate e pa imponime. Vetë masa e gjerë ka pasur kriteret rreth asaj se çka të pranojë për të vetën, çka të marrë me rezervë, çka me qëndrim kritik e çka të hedhë poshtë.

Karakterit njohës dhe edukues shprehet, pothuajse, në të gjitha llojet e krijimtarisë popullore që nga këngët e fëmijëve, ku edukohet qëndrimi i drejtë ndaj jetës e punës, si dhe ninullat ku shprehen caqet kulminante të dëshirave për veti të larta, begati e sukseste të reja në jetë, duke cytur në këtë mënyrë kah progresi, kah e reja, marrëdhëniet më të mira në mes njerëzve, humanizmi e barazia e deri te llojet e tjera të krijimtarisë letrare popullore. Kë-

shtu, fjala vjen, duke paraqitur gjendjen shpirtërore të të rinjve, gëzimin, fatin, kthesat, vuajtjet e dashurinë e pafat, në poezinë lirike shprehet edhe mllëfi ndaj shkaktarëve të vuajtjeve e ndaj atyre që e dëmtojnë harmoninë e atmosferën e këndshme familjare.

Në poezinë epike në përgjithësi e në atë historike veçanërisht ngrihet lart trimëria, heroizmi, burrëria, sakrificat për ideale të larta, ngrihet zëri kundër forcës, dhunës padrejtësisë dhe cenimit të dinjitetit njerëzor e kombëtar. Theksimi në mënyrë të veçantë i normave e vetive pozitive e shton efektin edukativ të këtyre krijimeve.

Aksionet e personazheve epike zhvillohen në harmoni me natyrën e ambientin, e shpesh dukuritë natyrore u paraprijnë ose i paralajmërojnë ngjarjet që vijnë. Edhe natyra rënkon nga e keqja, e zeza, ndërsa shëndrit nga bukuria mahnitëse, triumfi i së mirës e heronjve pozitivë.

Edhe format e tjera të prozës së shkurtër, si anekdotat, përrallëzat e të tjera me një humor tërheqës, paraqesin të metat e përgjithshme njerëzore e veçanërisht dobësitë e njerëzve të shtresave të larta ose me status të privilegjuar në shoqëri dhe vënë në dukje se cila është rruga e drejtë dhe për çfarë duhet të përcaktohet njeriu.

Fjalët e urta, po ashtu, me mendime të thukëta, ku akumulohet përvoja e njohuritë shekullore mbi njerëzit, marrëdhëniet në mes tyre, jetën e ambientin jetësor, kanë qenë shkollë e tipit të veçantë të bartjes e begatimit të kësaj përvoje.

Rëndësi të posaçme edukative kanë përrallat. Këtu në luftën e përhershme në mes të dy botërave, të mirës e të keqes, pos personazheve njerëzore, paraqiten edhe qeniet mitologjike, orët, zanat, shqiponja, dragoi e të tjera që veprojnë në favor të forcave pozitive dhe kuçedra si personifikim i forcave shkatërruese e negative. Zakonisht bartësit e së mirës dalin fitimtarë.²

Përfshirja territoriale e kohore e këngëve dhe e krijimeve të prozës popullore siguron komponentën njohëse të aspekteve të ndryshme të trajtimit të ngjarjeve, personazheve e dukurive, çka ofron lëndë të çmueshme për studimin e zhvillimit të përgjithshëm shoqëror dhe të transformimit të shoqërisë në periudha të ndryshme. Komponenta njohëse e folklorit gojor rreth ngjarjeve e dukurive ndikon në formimin e një qëndrimi kritik të arsyeshëm ndaj tyre. Mu për arsye të komponentës së theksuar edukative, ideoestetike dhe porosisë që ka, zakonisht, lënda e folklorit të ne prej çlirimit e deri më sot zë një vend të rëndësishëm në programet e në tekstet shkollë dhe në jetën tonë të gjithmbarshme kulturore, si pjesë e çmueshme e trashëgimisë sonë kulturore e kombëtare.

Krijimtaria jonë gojore, zakonisht, i ka shprehur idealet e kohës, ato të turmës, të masave të gjera, të fshatarësisë, ka shprehur karakterin e theksuar klasor të luftës për të renë. Kjo vërehet që nga marrëdhëniet e hershme shoqërore, pra, që nga feudalizmi, ka-

² Anton Çetta, *Prozë popullore nga Drenica*, „Rilindja” Prishtine, 1972, f. 19.

pitalizmi, Lufta Nacionalçlirimtare dhe ajo për ndërtimin e marrëdhënieve të reja shoqërore e transformimin e shoqërisë në përgjithësi.

Krijuesi i folklorit gojor, si në prozë po ashtu edhe në poezi, zakonisht, është në anën e të vegjëlve, të varfërve e të pambrojturve e kundër pushtuesve, shfrytëzuesve, si dhe kundër hipokrizisë dhe dukurive të tjera të ngjashme; ai gjithnjë i nxjerr fitues realë ose moralë ata që i mbron dhe thekson dështimin e qëllimeve të fshehta të mashtrimeve, të tradhtisë dhe të manifestimit të çfarëdo epërsie të shtresave sunduese. Për ta arritur këtë, ai përdor shumë figura e mjete të të shprehurit artistik. Nëprmet ironisë, alegorisë, simboleve, satirës e sarkazmit vë në dukje kontrastet në mes qëllimeve e tentimeve të shtresës së lartë në një anë dhe atyre të nënshtruesve në anën tjetër, duke e theksuar këtë në mënyrë të fuqishme në përfundimin e poezive të tilla. Satirizohen njerëzit e pushtetit, të rendit shfrytëzues, ata që e shtypin popullin. Bie fjala:

*Osman Çaus, mysteçegjatë,
Hajde mblidhi çeta pesë xhenaze,
Çoja pashës me ni sexhade!
Çoja pashës me sajdi
T'i pij meze me raki!³*

Siç shihet, në këto vargje theksohet në mënyrë të posaçme karakteri klasor i krijimtarisë popullore gojore. Numri i këngëve të tilla është i shumtë, veçanërisht nga ato që bëjnë fjalë për trimëri, për rezistencën kundër çfarëdo shfrytëzimi, shtypjeje ose keqtrajtimit, duke kërkuar zakonisht që përfaqësuesit e shtresave të larta e të pushtetit të jenë të matur e të arsyeshëm, të heqin dorë nga lakmia e tepërt e nga kërkesat e perealizueshme.

*Pa dëgjo, o beu inë,
Mbaje mirë terezinë,
Se njerëzia u fiknë.⁴*

Sepse çdo gjë e ka kufirin e vet, përtej të cilit nuk mund të shkohet. Atëherë vjen rezistenca ose kërcënimi i hapët:

*E pe Abdul Be Selimnë?
Kullat e bardha në brinjë,
Kukumjaçkat ulrijnë
Ashtu do t'i lesh' dhe tinë.⁵*

Trajtimi dhe krijimi i personazheve pozitive e negative, stigmatizimi i të gjitha dukurive e karaktereve të dobëta të shoqërisë ndi-

³ *Këngë popullore historike*, Instituti i Folklorit, Tiranë 1956, f. 202.

⁴ *Po aty*, f. 254—255.

⁵ *Po aty*.

kon në krijimin e personalitetit, karakterit dhe moralit të brezit të ri.

Pothuajse të gjitha zhanret dhe llojet e folklorit gojor vazhdojnë të kultivohen edhe më tutje dhe, në suazat e formës së të shprehurit të tyre, ofrojnë porosi, mendime, drejtësi dhe zgjidhje të tyre të pranueshme. Kjo theksohet edhe në llojet e prozës popullore. Përrallat, bie fjala, i karakterizon komponenta e theksuar edukative, porosia humane, zgjidhjet në favor të së drejtës, të mirës, duke nxjerrë në shesh dobësitë njerëzore dhe duke i damkosur padrejtësitë, dukuritë dhe anët negative në përgjithësi. Natyrisht, kur bëhet fjalë për krijimtarinë letrare popullore, gjithnjë duhet dalluar se cilat janë krijime me vlerë reale të përhershme, çka është improvizim i rastit, çka edukon në frymë të shëndoshë, çka mban porosi të duhur, çka shpie përpara e çka zgjon asociacione të dëmshme e ushtron ndikim negativ. Kujdes të posaçëm meritojnë ato krijime e vepra letrare që zhvillojnë besim në jetë, në të ardhmen e njeriun në përgjithësi.

Një ndër temat e rëndësishme që trajtohet në letërsinë popullore janë edhe përpjekjet për një bashkëjetesë të njëmendtë, e cila është e pranishme në folklorin tonë që nga luftërat e përbashkëta për çlirim nga sunduesi shekullor osman e deri te Lufta Nacionalçlirimtare. Shembuj luftërash të përbashkëta dhe vdekjesh kre-nare të shqiptarëve me pjesëtarët e kombeve të tjera janë të shumtë që nga Ali Farmaqi, i cili vritet në luftë me përfaqësuesit e pushtetit osman, duke mos pranuar të ndahet nga bashkëluftëtari grek Kollokotroji⁶ e deri te Boro e Ramizi dhe shumë shembuj të tjerë të ndritshëm nga periudha e Luftës Nacionalçlirimtare.

Poezia popullore shqiptare i ka përshëndetur lëvizjet përparimtare e çlirimtare të popujve të tjerë dhe ato i trajtor pa kurrfarë ngarkesash. Pra, si çdo krijimtari tjetër shpirtërore, përpos elementeve të tjera, edhe letërsinë gojore e përshkon një ndjenjë e thellë humanitare e qëndrimit ndaj njeriut, veprimit të tij, synimit për një jetë më të mirë e më të begatshme — njeriut pa dallim kombi e përkatësie fetare.

Poetët popullorë asnjëherë nuk u kanë kënduar individëve të izoluar nga mjedisi, nga masa e gjerë e popullit. Personazhet pozitivë zakonisht paraqiten në raport me ambientin dhe me synimet e mesit përkatës. Kështu u këndohet shumë trimave e luftëtarëve që sakrifikuan jetën për liri e drejtësi, për jetën e lirë të njeriut. Në këtë vazhdë ekziston një numër i madh heronjsh e trimash që janë përjetësuar në këngë. Krijuesit gojorë, siç u theksua më lart, një numër këngësh ua kanë kushtuar ngjarjeve dhe trimave nga Lufta Nacionalçlirimtare dhe ndërtimit socialist. Nga të gjitha këto figura në këtë poezi shquhet shoku Tito, në fytyrën e të cilit mishërohen të gjitha përpjekjet e luftës e të pasluftës të kombeve e

⁶ Vehbi Bala, *Kontribute shqiptare në visarin e përbashkët të popujve*, „Drita”, Tiranë 13 maj 1979, f. 12.

kombësive tona dhe duke e pasqyruar nëpërmjet tij kontinuitetin e luftës së vazhdueshme për liri e pavarësi, për barazi dhe për ndërtimin e marrëdhënieve të reja shoqërore.

Lufta Nacionalçlirimtare pasqyrohet si luftë e drejtë e udhëqur nga populli dhe për të mirën e tij. Përjetësimi artistik i heroizimit të luftëtarëve të shquar në vargje edukon disponimin revolucionar e luftarak për ruajtjen e fryteve të revolucionit.

Theksimi i përpjekjeve të vazhdueshme për një jetë më të mirë, lartësimi i vetive moralo-etike e njerëzore, i respektit, kultit ndaj të parëve dhe traditës pozitive kombëtare, që janë prezente në folklorin tonë gojor, duke i forcuar dhe kultivuar cilësitë më pozitive të karakterit të njeriut, po ashtu i kontribuon komponentës edukative.

Qëndrimi ndaj atdheut e lirisë së tij, ndaj popullit, ndaj paqes dhe gatishmëria për sakrificë më të mëdha për liri e pavarësi, qëndrimi ndaj luftëtarëve e heronjve, ndaj gjithë atyre që kanë dhënë jetën për një të ardhme sa më të mirë — të gjitha këto ndikojnë në edukimin e drejtë socialist dhe human të njeriut. Me tema e vargje të tilla është mjaft e pasur letërsia jonë popullore.

*Luftojnë trimat n'ato shkrepa,
për liri s'u dhimet jeta,
e bajnë vdekjen si me le
për liri e për atdhe.⁷*

Një ndër ndikimet më të rëndësishme që ustron folklori në njeriun tonë është edukimi artistik e estetik. Nëpërmjet vargjeve artistike, kuptimisht të plota, me një porosi të shëndoshë e të qartë, që realizohen nëpërmjet gjuhës poetike të folur, krijimet e letërsisë popullore gojore ndikojnë dukshëm në vetëdijen e njeriut dhe nëpërmjet shijes artistike e bëjnë njeriun më fisnik, e aftësojnë të ushtrojë edhe ndikime të tjera dhe që për atë të ketë kritere të qëndrueshme. Me fjalë të tjera, duke e fisnikëruar dhe begatuar njeriun nga aspekti artistik, atë e begatojnë edhe për aspekte të tjera, si fjala vjen, të jetë humanist, internacionalist, ta dojë të mirën e të drejtën, ta çojmë drejt të bukurën, të ketë ndjenjën e marrësisë, të arsyes e të realitetit. Të gjitha këto ndikojnë edhe në qëndrimin më aktiv dhe kreativ të dëgjuesit, ndikojnë në zhvillimin e cilësive më pozitive të karakterit.

Nëpërmjet gjuhës poetike të krijimeve të letërsisë popullore, edukohet shija estetike, fisnikërohet bota shpirtërore dhe ndikohet dukshëm në edukimin artistik të njeriut tonë të ri. Kjo arrihet nëpërmjet vargjeve të thukëta, shprehjeve të dendura e të kursyera, me figura të qëlluara stilistike, që krijojnë tablo e skena madhështore artistike. Mjafton të sjellim këtu vargjet ku përshkruhet bu-

⁷ *Gjurmime albanologjike — Folklor e etnologji*, V/1975, Instituti Albanologjik i Prishtinës — Materiale, f. 244.

kuria e Tanushës e të bindemi në nivelin e lartë poetik, estetik dhe artistik të këtij thesari të çmueshëm:

*Gja ma t'mirë s' sheh njeri nën kët diell!
Vetlla e saj ndrejt si fiskaja;
shteku i ballit, si shteku i malit
kur merr hana me prarue;
syni i saj, si kokrra e qershisë;
e ka qerpikun si krah i dallëndyshës;
ftyra e saj, si kuqet molla n'degë;
hunda drejt, si kalemi i Tushës,
goja e vogël, si lula si shpërthen;
dhambët e bardhë, si gurzit e lumit
fill mbas shiut kur po i shndrit dielli;*

*qafa e saj, si qafa e pllumbit;
shtati i saj, si shtat çetinet;
misht e dorës, pors i rremi i shemshirit.⁸*

Në folklorin tonë letrar bashëkohor sot këndohet për tema të reja. I këndohet barazisë, bashkëjetesës, vëllazërimit e bashkimit, qëndrimit të drejtë ndaj çështjes kombëtare, ndërtimit të marrëdhënieve socialiste vetëqeverisëse, ndërtimit të vendit, fytyrave të dalluara në luftë dhe në ndërtimin socialist. Posaçërisht këndohet për shokun Tito si strateg lufte e paqe, si luftëtar për barazi dhe për mirëqenie të njerëzve. Në vargje shprehet edhe ajo si i ndien dhe i kupton populli, respektivisht krijuesi popullor idetë e prijësit të vet.

*Shoku Tito me shoqni,
janë betue n'nerë e n'parti:
kush t'banon n'Jugosllavi,
pa dallim fe e komsi
gjithsekujt me i dhanë munsit,
me ba shkollë e me pasë di'.
mos me metë kush n'vorfni.*

Folklorin gojor e karakterizon edhe një notë e theksuar internacionalizmi. Kjo shprehet me faktin se në krijimet e letërsisë popullore nëpërmjet individit pasqyrohet praktika e vetëdijes kolektive, përkatësisht e popullit. Ky edukim arrihet në mënyrë efektive nëpërmjet shumë krijimeve të letërsisë popullore, ku nuk përcaktohet vendi, koha, përkatësia nacionale e të tjera. Me këtë lidhet edhe fakti se krijimet e folklorit gojor ndikojnë në afrimin e njerëzve të kombeve e shteteve të ndryshme, me tema të njëjta e të ngjashme, dhe në këtë mënyrë krijimet e këtilla luajnë rol të

⁸ Folklori shqiptar II, Epika legjendare, Vëllimi I, Instituti i Folklorit, Tiranë 1966, f. 73.

shumfishtë në afrimin dhe në humanizimin e njerëzve. Pra, arti në përgjithësi dhe krijimtaria popullore gojore në veçanti fisnikë-rojnë dhe ndikojnë pozitivisht në formimin e përgjithshëm të brez-nive.

Fazli Syla

LA LITTÉRATURE POPULAIRE, FACTEURS DE CONNAISSANCE ET D'ÉDUCATION

Résumé

Par l'intermédiaire des thèmes, des événements et des différents phénomènes qui sont en rapport étroit avec le monde de l'homme et son action, les oeuvres littéraires orales comme aussi les oeuvres littéraires en général, parallèlement au développement du sentiment artistique obtenu grâce à la langue poétique concrétisée dans le texte artistique, offrent des indications précises. Ces messages, avant tout artistiques plongent le lecteur dans l'essence de nombreux phénomènes de la réalité humaine, des questions existentielles et des dilemmes auxquels l'homme se trouve constamment affronté; En traitant de telles questions et en donnant divers renseignements l'oeuvre littéraire traduit l'attitude de l'auteur en même temps que sa position et sa détermination qui reflète une grande expérience du milieu où il vit, et par conséquent de l'homme en général. L'oeuvre littéraire orale de par ses éléments constitutifs nous permet d'approfondir les problèmes concernant les rapports sociaux et communautaires ainsi que la vie intérieure de l'homme. Elle parvient à cela par l'intermédiaire des événements et des diverses actions qu'elle expose, par les personnages, porteurs des préoccupations de leur temps et représentants de l'homme et de la société qui expriment les desseins d'une classe déterminée et manifestent aussi les contradictions d'un milieu et les rapports sociaux respectifs. Une telle présentation, concernant les attitudes et les diverses positions données qui nous sont présentées dans une oeuvre littéraire orale permettent, non seulement aux créations littéraires d'exister et de jouer un rôle, mais influent aussi positivement sur la formation du caractère, sur une saine éducation et le développement du sentiment esthétique.